

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Komunitetet e energjisë së rinovueshme/ ERE përcakton kriteret e regjistrimit dhe monitorimit
ADRESA	https://www.cna.al/aktualitet/komunitetet-e-energjjise-se-rinovueshme-ere-percakton-kriteret-e-regji-i474215
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 11:34:38 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 11:26:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	ad91eca070f263ae590a0aec3474874059678c263bc6609ceb1628c3a1d79296
TEKSTI	a84c56bdc06d5f6eb4a50f119271341039c267e7a118451ae91d7db87a88f318
PAMJA	e8f603b0491318e4383e0ea8e72520a8ad7ec5f477200182bde1008231129d9

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	204a07b108eee3e23c86002a9e8da2100f72e0aa52ea01079741c02d051442b6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5f8ef0f8d1c556c1a23c45b5f0b4a2927fefdb161a9dff8be1ca6faf0b0d4224
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/204a07b108eee3e23c86002a9e8da2100f72e0aa52ea01079741c02d051442b6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

Komunitetet e energjisë së rinovueshme/ ERE përcakton kriteret e regjistrimit dhe monitorimit



15 Shtator 2026, 13:26, Aktualitet CNA



Komunitetet e energjisë së rinovueshme do të duhet të regjistrohen pranë Entit Rregullator të Energjisë (ERE) për të ushtruar aktivitetet e parashikuara nga kuadri ligjor, ndërsa rregullat për krijimin, administrimin dhe kontrollin e tyre përcaktohen në projekt-rregulloren e hartuar nga ERE. Dokumenti përcakton procedurat për paraqitjen, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesave për regjistrimin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme (KER), kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë subjektet që kërkojnë këtë status, krijimin dhe administrimin e regjistrimit të komuniteteve, si dhe kushtet për pezullimin ose rikthimin e statusit aktiv.

Sipas projekt-rregullores, KER përkufizohet si një subjekt juridik i krijuar dhe që vepron mbi bazën e pjesëmarrjes së hapur dhe vullnetare të anëtarëve të tij, me qëllim realizimin e aktiviteteve të parashikuara nga legjislacioni për energjinë nga burimet e rinovueshme. Çdo komunitet që kërkon të ushtrojë të drejtat dhe aktivitetet e parashikuara për KER-të duhet të regjistrohet pranë ERE-s. Megjithatë, regjistrimi do të ketë karakter administrativ dhe nuk do të zëvendësojë licencat apo autorizimet që kërkojnë për aktivitete të caktuara në sektorin energjetik.


“Regjistrimi në ERE është procedurë administrative e veçantë me karakter evidentues dhe administrativ dhe nuk përbën licencim apo autorizim për ushtrimin e aktiviteteve që sipas legjislacionit në fuqi kërkojnë licencë ose autorizim, përfshirë prodhimin, furnizimin, transmetimin ose shpërndarjen e energjisë elektrike”, përcakton projekt-rregullorja.

Kërkesa për regjistrim do të paraqitet nga përfaqësuesi ligjor i komunitetit dhe do të shoqërohet me formularin përkatës të regjistrimit. Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna për emërtimin dhe formën juridike të komunitetit, numrin unik të identifikimit, adresën e selisë, aktivitetin e planifikuar, listën e anëtarëve themelues, përshkrimin e centralit prodhues, kapacitetin e instaluar dhe vendndodhjen e impianteve. Për regjistrimin, subjektet duhet të dorëzojnë gjithashtu statutin dhe aktin e themelimit, marrëveshjen me operatorin e sistemit për përdorimin e rrjetit, përshkrimin e instalimeve të planifikuara dhe hartën e vendndodhjes së tyre. Për komunitetet me kapacitet të instaluar mbi 100 kW kërkohej edhe një plan biznesi me vlerësim teknik dhe financiar për pesë vitet e para.

ERE do të shqyrtojë përputhshmërinë e dokumentacionit brenda 10 ditëve pune nga depozitimi i kërkesës. Në rast se dokumentacioni rezulton i paplotë, aplikanti do të njoftohet për mangësitë dhe do të ketë 20 ditë pune për të paraqitur informacionin shtesë. Pas përfundimit të procesit të verifikimit, ERE do të vendosë për regjistrimin ose refuzimin e kërkesës. Në rast miratimi, komuniteti do të pajiset me numër regjistrimi brenda tre ditëve pune dhe të dhënat e tij do të pasqyrohen në Regjistrin e Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme. Regjistri do të administrohet në formë elektronike nga ERE dhe do të përmbajë të dhëna për emërtimin e komunitetit, numrin dhe datën e vendimit të regjistrimit, adresën, numrin e anëtarëve, kapacitetet prodhuese dhe statusin e regjistrimit.

Komunitetet e regjistruara do të kenë detyrimin të njoftojnë ERE-n për ndryshimet në të dhënat e deklaruara gjatë regjistrimit, përfshirë strukturën organizative, përbërjen e anëtarësisë, administratorin ose përfaqësuesin ligjor, kapacitetet prodhuese dhe të dhënat e kontaktit. Njoftimi duhet të bëhet brenda 30 ditëve kalendrike nga data e ndryshimit. Projekt-rregullorja parashikon edhe mekanizmat e kontrollit dhe monitorimit nga ERE. Institucioni do të ushtrojë këto funksione përmes shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga komunitetet, verifikimeve administrative dhe kërkesave për informacion shtesë. ERE mund të vendosë pezullimin e statusit aktiv të një komuniteti në rast se nuk plotësohen më kriteret ligjore, nuk përmbushen detyrimet për raportim ose informacion, paraqiten të dhëna të pasakta apo pengohet procesi i verifikimit dhe kontrollit.

Përpara vendimit për pezullim, komuniteti do të njoftohet për shkaqet e procedurës dhe do t'i jepet një afat jo më pak se 7 ditë kalendrike për të paraqitur shpjegime ose për të korrigjuar mangësitë e konstatuara. Sipas projekt-rregullores, KER-të duhet të raportojnë pranë ERE-s deri më 31 janar të çdo viti të dhënat dhe informacionin për vitin paraardhës. Informacioni i raportuar duhet të jetë "i plotë, i saktë dhe i përditësuar", ndërsa ERE mund të kërkojë sqarime shtesë për verifikimin e përmbushjes së kërkesave ligjore./Monitor



Kush ishte Zai Fundo?

Të sugjeruara

Statusi i gjyqtarëve dhe prokurorëve/ Nis seanca dëgjimore te Komisioni i Ligjeve

Gjykata e la në qeli; A do të vazhdojë Erion Veliaj të mbajë peng Tiranën?

Pagat e gjyqtarëve/ Gogu te “Ligjet”: Kuvendi humbi afatin, por zgjidhja bëhet me ligj

“Kalohen me 99.9% të fondit”/ Debate te Komisioni për Nismat Qytetare për tenderët

Kërkoi lirimin nga qelia/ GJKKO jep vendimin për Metën

Veliaj ngelet në burg/ Protestuesit brohorasin për vendimin ndaj kryebashkiakut

Goditja e radhës për Erion Veliajn/ Gjykata e Lartë e lë në burg

Rritja e çmimit të naftës/ Bozdo: Situata emergjente, qeveria të ndërhyjë me lehtësira fiskale

Audio-përgjimi për Ron Yeffet/ Kalaja: Rama ka dalë zbuluar me korrupsionin e tij

Seanca për Veliajn/ Protestë para Gjykatës së Lartë

Emërohet Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së

Dosja “Revanshi”/ GJKKO shpall vendimin për Durim Bamin dhe 6 të tjerë

“O gjyqtar bëj drejtësi, lër Veliajn në qeli”/ Thirrja e protestuesve para Gjykatës së Lartë

Erion Veliaj kërkon të kthehet në vendin e krimit/ Sot, seanca në Gjykatën e Lartë

Projekti për bujqësinë/ BB: Mund të ristrukturohet ose të anulohen fonde

Protesta para shkollës/ Hoxha: Goditja ndaj protestuesit ishte për ta përkulur

“Rama dhunoi pasagjerin”/ Berisha: Kreu i organizatës çan me thonj qytetarin

“Nëse e keni harruar, kujtohuni nesër”/ Gjokutaj, mesazh gjykatave për afatet e paraburgimit

Audio-përgjimi/ Këllici: Roni i Ramës paska të gjithë qeverinë në dorë


Gazetari: 30 milionë euro të taksapaguesve janë dhënë për makina që saldohen në një kapanon

[editorial](#)

11:57 Editorial

Kur propaganda dhe mashtrimi dështojnë përballë drejtësisë

CNA LIVESTREAM



Na ndiqni edhe në



[acromax](#)

19:53 Acromax / Aldor Nini

Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH

[opinion](#)

20:44 Opinione Albert Vataj

Ekspertët zbulojnë shtatë siellie të cuditshme që mund të lidhen me inteligjencën e lartë

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.